

VENDIMI
Nr.12, datë 26.10.1993

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Manol Konomi,	Anëtar i “ “
Hilmi Dakli,	Anëtar i “ “
Veli Budo	Anëtar i “ “
Franc Jakova,	Anëtar i “ “
Thimjo Kondi,	Anëtar i “ “
Ylvi Myrtja,	Anëtar i “ “
Natasha Sheshi,	Anëtare e “ “

Me sekretare Drita Filto, më datat 21.9.1993 dhe 26.10.1993, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.13 akti që i përket:

KËRKUES: Keshilli I Rrethit Tepelene, i përfaqësuar në gjyq nga kryetari i këtij këshilli Hamid Gjoni dhe Sulo Liçi, jurist në atë këshill

OBJEKT: Anullimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.248, datë 27.5.1993 “Për disa masa për shpejtimin e privatizimit të ndërmarrjeve të vogla e të mesme sepse:

1. Vendimi vjen në kundërshtim me ligjin nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanskionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, pasi në këtë ligj thuhet se kalimi i pronës shtetërore në pronë private do të bëhet vetëm me ligj.

2. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nuk shprehet fare se kush e drejton bordin e privatizimit në rreth.

3. Nuk është e drejtë pika 19 e Vendimit të Këshillit të Ministrave.

4. Nuk është e drejtë që sipas pikës 4 e 5 të këtij vendimi dokumentacioni për privatizimin e ndërmarrjeve të ruhet vetëm për një vit.

GJYKATA KUSHTETUESE

Pasi dëgjoi relacionin përkatës,

VËREN:

Ligji Nr.7512, datë 10.08.1992, nenin 1, parashikon shprehimisht privatizimin e pronës shtetërore dhe gjithë procesin e kalimit të ekonomisë së planifikuar në një ekonomi të tregut të lirë.

Po me anën e këtij ligji, neni 22, paragrafi I, është krijuar Agjencia Kombëtare e Privatizimit, e cila është kompetente të organizojë tërë punën në lidhje me procesin e privatizimit, duke shpallur formën dhe radhën e objekteve që do të privatizohen.

Ligji i lartpërmendur, neni 23, paragrafi I, njëkohësisht cakton se kalimi i pronës shtetërore në pronë private bëhet, përveç nëpërmjet ankandit edhe me çdo mënyrë tjetër.

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.248, datë 27.05.1992, i është përmbajtur parimeve të shprehura në Ligjin Nr.7512, datë 10.08.1992. Në pikën 2, paragrafi II të këtij vendimi caktohet në mënyrë përjashtimore, se privatizimi mund të bëhet pa ankand për persona juridikë ose fizikë të veçantë, por gjithnjë në kushtet që përmenden në pikën 12 të këtij vendimi, mbi bazën e leverdisë sociale, ekonomike e kulturore, kushte këto që lihen në çmimin e bordit të degës së Agjencisë Kombëtare të Privatizimit në rreth.

Nga përmbajtja e këtyre dispozitave del e qartë se Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.248, datë 27.05.1992, nuk vjen në kundërshtim me Ligjin Nr.7512, datë 10.08.1992, në përgjithësi dhe as me normën e nenit 23 paragrafi I të këtij ligji.

Kërkesat e tjera që parashtron pala nuk formojnë objekt shqyrtimi nga ana e kësaj Gjykate, për arsye se me anën e tyre, kërkohet përmirësimi i disa pikave të Vendimit të Këshillit të Ministrave, gjë që është në kompetencën e tij.

Sipas nenit 23, paragrafi III i Ligjit Nr.7561, datë 29.04.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin Nr.7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", Gjykata Kushtetuese gjykon papajtueshmërinë e akteve dhe dispozitave nënligjore me Kushtetutën dhe me ligjin.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 26 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese".

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës si të pabazuar.

Vendimi është përfundimtar dhe i formës së prerë.

Vendimi hyn në fuqi menjëherë.